

Datë, **10.02.2022**

Thirrje publike për aplikim – Mentorë për Organizata të Shoqërisë Civile

Numër reference: Nr 001 01/2023

Sfondi i përgjithshëm:

Centar za promociju civilnog društva (CPCD), në partneritet me Qendrën për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) nga Maqedonia e Veriut dhe Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) nga Shqipëria, po zbaton projektin SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor. Ky projekt kontribuon në forcimin e demokracisë dhe integrimin euroatlantik të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Projekti synon të krijojë zhvillim të qëndrueshëm në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Disa nga temat e këtij projekti janë lufta kundër krimit të organizuar, parandalimi i radikalizimit (përfshirë ekstremizmin e dhunshëm), pajtimi përmes dialogut ndërkulturor, reformat në integrimin euroatlantik, të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore (përfshirë dhunën në familje), mbështetje të lirisë së fjalës dhe mbështetja për mediat e pavarura. Projekti financohet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë, me një grant prej mbi 17 milionë euro.

Konsorciumi i Projektit SMART Balkans shpall një Thirrje publike për Aplikim për **Mentorë Kombëtarë**.

Kushtet e referencës për këtë thirrje janë të disponueshme në Shtojcën 1 të kësaj thirrje.

Si të aplikoni:

Aplikimi për Mentorë Kombëtarë duhet të dorëzohet në adresën e email-it grants3@smartbalkans.org dhe duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

- Formulari i Aplikimit (Shtojca 1)
- CV
- Deklaratë Nderi (Shtojca 3)
- Dokumente të tjera që verifikojnë fushën e ekspertizës dhe specifikojnë kualifikimet e aplikantëve.

Aplikimet duhet të dërgohen me specifikimin e aplikimit në subjektin e emailit: Aplikim, NR 001 01/2023 (emri i aplikantit). Në përmbajtjen e email-it duhet të listohen të gjitha dokumentet e dorëzuara dhe dokumentet të jenë të emëtuara siç janë renditur në këtë seksion. Të gjitha dokumentet që përmbajnë nënshkrime duhet të dorëzohen në formatin PDF. Madhësia maksimale e emailit mund të jetë 10 MB. Në rast se dokumentet e bashkangjitura janë më të mëdha se 10 MB, dërgoni dokumentet në disa emaile: në e-mailin e parë shkruani Aplikimi, NR 001 01/2023 (emri i aplikantit) x / # , në vend të shenjës "x" futni numrin serial të e-mailit, dhe në vend të shenjës "#" shkruani numrin total të e-maileve që do të dërgoni.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit për thirrje është data 26/02/2023 ora 16:00.

Me dorëzimin e aplikimit, të gjithë aplikuesit bien dakord që aplikimi i tyre do të ruhet për 36 muajt e ardhshëm dhe se ata mund të kontaktohen nga partnerët e Konsorciumit nëse është e nevojshme.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Dokumentet shtesë:

Shtojca 1 – Termat e Referencës për Mentorë Nr 001 01/2023

Shtojca 2 – Formulari i Aplikimit për Mentorë Nr 001 01/2023

Shtojca 3 – Deklaratë Nderi Nr 001 01/2023